



**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik "STERKAJ" shpk

**Adresa:** Njësia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2, Tiranë

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit: "Rikonstruksion dhe shtesë anësore e çerdhes nr.8".**

**Nr. References, REF 05714 -01 -30-2019**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është **"Rikonstruksion dhe shtesë anësore e çerdhes nr.8"**, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

**Fondi limit: 13.313.313** (trembëdhjetë milion e treqind e trembëdhjetë mijë e treqind e trembëdhjetë ) **lekë pa TVSH.**

**Burimi i financimit:** Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 159, datë 21.12.2018, për "Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, me objekt **"Rikonstruksion dhe shtesë anësore e çerdhes nr.8"**.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 6 ( gjashtë ) muaj nga momenti i lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 04.03.2019 , Ora: 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 5 datë 04.02.2019.**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Oferta e paraqitur nga Bashkimi Operatorëve Ekonomik “2Z Konstruksion” shpk & “Anbi” shpk**  
K02715442R  
NUIS J 63229466K &

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **10.155.718** (dhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

2. **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Eurondertimi 2000 ”shpk, me nr.**

NUIS K 02003001 O

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **9.590.944** (nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë.

3. **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Operatori Ekonomik “Sireta – 2F” shpk**

NUIS K 51501008 J

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **11.888.888** (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

4. **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk**

NUIS K67106202W

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **0 (zero)** lekë

5. **Operatori Ekonomik “Sterkaj” shpk**

NUIS J68310708M

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **12.007.234,4** (dymbëdhjetë milion e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e katër presje katër) lekë

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. **Bashkimi Operatorëve Ekonomik “2Z Konstruksion” shpk & “Anbi” shpk**  
NUIS J63229466K & K02715442R

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “2Z Konstruksion”shpk & “Anbi” shpk, nuk plotësojnë pikën 2.7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e punonjësve të pasqyruara në list pagesa per 3(tre) muajt e fundit të paktën 6 (gjashtë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të, të vlefshme, ku nga këta të jenë të paktën: 1(një) punonjës me kategori të IV dhe 1 (një) punonjës me kategori të V*”, Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë punonjës me kategori të IV dhe asnjë punonjës me kategori të V.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “2Z Konstruksion”shpk & “Anbi” shpk, nuk plotësojnë pikën “2.7,” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2(dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda të cilët duhet jenë automakinist. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit”,* Operatori Ekonomik 2Z Konstruksion shpk ka paraqitur vetëm një punonjës manovrator, i pajisur me dëshmi drejtimi automakinist, ndërsa Operatori Ekonomik ANBI shpk ka paraqitur një punonjës me dëshmi drejtimi eskavatorist.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “2Z Konstruksion”shpk & “Anbi” shpk, nuk plotëson pikën 3, të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10), Kamioncinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioncinë nga 1(një) ton deri në 2 (dy) ton, 2 copë”.*

Bashkimi Operatori ekonomik “2Z Konstruksion”shpk & “Anbi” shpk, nuk plotëson pikën 3,” të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion)”,* pasi BOE, i lartpërmendur nuk kanë paraqitur asnjë Kamion vetëshkarkues me kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion të rregullt.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatorëve Ekonomik të mësipërm është i paplotë pasi nuk kanë përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur dokumentacionin e duhur në mënyrën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit të kërkuar nga AK

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **2. Operatorit Ekonomik “Eurondertimi 2000 ”shpk NUIS K020030010**

Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10) ku janë kërkuar 4 (katër) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion”* ka paraqitur dokumentacion per një kamion .

Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10) ku janë kërkuar 2(dy) Kamioncina me kapacitet mbajtës minimumi 1(një) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamioncine”* ka paraqitur dokumentacion vetem per një

kamioncine.

Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, konkretisht pika 2.9 ku kërkohet: *Operatori ekonomik pjesmarrës të ketë në staf të punësuar si më poshtë si dhe të rezultojnë në listpagesat e shqërisë për të paktën 3(tre) muajt e fundit 1(një) inxhinier – Auditues Energjie i pajisur me “Certifikatë për auditim e energjise” operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.*

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik i mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur dokumentacionin e duhur në mënyrën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit të kërkuar nga AK

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **3. Operatori Ekonomik “Sireta – 2F” shpk me NUIS K71401004W**

Operatori Ekonomik “Sireta – 2F” shpk nuk plotëson pikën 2.3 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pika 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve, liçensën profesionale të shoqërisë.*

Operatori Ekonomik “Sireta – 2F” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10) ku janë kërkuar 4 (katër) Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 (tre pik pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion” nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitet mbajtës sipas kërkesës së AK.*

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik i mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur dokumentacionin e duhur në mënyrën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit të kërkuar nga AK

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### **4.Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk , me NUIS K67106202 E**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “ELDA-VL” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik“ELDA-VL” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### **Janë shpallur si ofertues të suksesshëm:**

##### **1. Operatori Ekonomik “Sterkaj” shpk NUIS J68310708M, kualifikohet në vend të parë**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **12.007.234,4** (dymbëdhjetë milion e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e katër presje katër) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **14.408.681,1** (katërbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një presje një) **lekë.**

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 6 (gjashtë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **12.03.2019**

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, **Operatorin Ekonomik “Sterkaj” shpk**, me NUIS J68310708M, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme

pa tvsh = **12.007.234,4** (dymbëdhjetë milion e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e katër presje katër) **lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar